



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.



Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 5300

Nr. 6221 Prot.



Tiranë, më 02.12.2021

Drejtuar : **Qendrës Kombëtare të Biznesit**

Për dijeni: **Z. Preng Doda (Subjekti OSHMA "TV Kabllor Besëlidhja")**

Adresa: Rrëshen, Lagjia 1, Rruga "Gjergj Fishta", godina e Pallatit të Kulturës kati 2

Autoritetit të Mediave Audiovizive

Lënda : *Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative*

Në Tiranë, sot më datë 02.12.2021,

Unë **Edvin Malotaj**, përmbarues gjyqësor privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, i pajisur me çertifikatë Nr. 106, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Vendimit Nr.1892 (31134-047513-80-2021), datë 27.07.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 11.11.2021, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Vendimit Nr.1892 (31134-047513-80-2021), datë 27.07.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë:

Kreditor : Autoriteti i Mediave Audiovizive

Debitor : Preng Doda (Subjekti OSHMA "TV Kabllor Besëlidhja")

Me Objekt : *kthim shume*

Me vendimin Nr.1892 (31134-047513-80-2021), datë 27.07.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur:

"Pranimin e kërkesës.

NIPT: L21825003E

Çertifikatë për ushtrim veprimtarie Nr: 26, Nr. 98, Nr. 83, Nr. 106
LN-5367-06-2012

Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e dënimit me gjobë nr.1 datë 21.07.2020 të Grupit të Inspektimit të Drejtorisë së Mbikqyrjes pranë AMA – s, të vendosur ndaj personit fizik z. Preng Doda, autorizuar për subjektin OSHMA “Tv Kabllor Besëlidhja”, lënë në fuqi me vendimin nr.69, datë 21.08.2020 të AMA-s.

Urdhërimin e shërbimit përmbartimor për zbatimin e këtij vendimi.”

Me shkresën Nr. 5762 Prot., datë 11.11.2021 debitorit i është komunikuar afati për ekzekutimin vullnetar.

Sa më sipër bazuar në 527 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.26/2019, datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat” dhe Udhëzimit Nr. 385/7, datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor privat”

URDHËROJ:

- 1- Qendrën Kombëtare të Biznesit të vendosë masën e sekuestros konservative mbi aktivet e rregjistruara pranë jush që zotëron pala debitore:
 - **Person fizik Preng Doda (Subjekti OSHMA “TV Kabllor Besëlidhja”), me NIPT L69012001L**, për ekzekutimin e vendimit Nr.1892 (31134-047513-80-2021), datë 27.07.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- 2- Këto aktive të qëndrojnë të bllokuara deri në një urdhër të dytë.
- 3- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.
- 5- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Përmbartues Gjyqësor Privat


Edvin Malotaj



NIPT: L21825003E

Çertifikatë për ushtrim veprimtarie Nr: 26, Nr. 98, Nr. 83, Nr. 106

LN-5367-06-2012